



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 3, 4 dhe 5 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015, duke vendosur sipas kërkesës së OJQ “HandiKos” Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 200 (dyqind) euro, sipas kërkesës së OJQ “HandiKos” Lipjan sipas kërkesës së tyre të dates 07.10.2016.

Mjetet e cekura në paragrafin paraprak i ndahen për ta mbështetur financiarisht OJQ “HandiKos” Lipjan, në realizimin e Projektit “Tetori muaji mundësive të barbarta” i cili planifikohet të realizohet në Tetor në kuadër të objekteve të administratës komunale, ku do të punësohen për periudë dy ditore 10 persona me aftësi të kufizuara që do të paguhet me nga 10 euro në ditë, gjithsej 200 Euro për dy ditë, sipas Listës së propozuar nga OJQ “HandiKos” Lipjan.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të OJQ-së nr. 1907960372031135 në Banka Kombëtare Tregtare.

Neni 3

Obligohet OJQ “HandiKos” në Lipjan që të sjellë regjistrin me nënshkrimet e personat e përzgjedhur për Projektin “Tetori muaji i mundësive të barabart”.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet OJQ “HandiKos” Lipjan, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtorati për Administratë dhe Njësi për të drejtat e njeriut barazi gjinore në Lipjan.

1Nr. 112-56022
Lipjan, më 10.10.2016

